



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2029/1 prot.

Tiranë më 6.7.2023

Lënda: Mbi bashkërendimin e një Projektvendimi.

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka administruar shkresën tuaj me nr. 8208/1 prot., datë 03.07.2023, përmes së cilës dërgohet për bashkërendim projektvendimi për “Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Shtetit të Izraelit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi ndihmën e ndërsjelltë në çështjet doganore.” (në vijim “Projektvendimi”) së bashku me relacionin përkatës.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit të vendosur në dispozicion, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në tërësi përmbajtja e tij implementon standardet e mbrojtjes së të dhënave personale. Konkretisht, konstatojmë se përveç neneve 11 dhe 12, përkatësisht “Konfidencialiteti” dhe “Mbrojtja e të dhënave personale”, ky projektvendim ka dhe një aneks të dedikuar “Parimet për mbrojtjen e të dhënave”(në vijim “Aneksi”).

Sugjerimi i vetëm i Zyrës së Komisionerit i referohet pikës 2 të Aneksit, konkretisht përshtatjes së përkthimit të kësaj pike sipas kontekstit që ka në gjuhën angleze, sipas përmbajtjes në vijim:

“Të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike ose besimet fetare ose të tjera, si dhe të dhënat personale në lidhje me shëndetin dhe jetën seksuale, nuk mund të përpunohen automatikisht, përveçse nëse ligji vendos parashikim masa mbrojtëse të përshtatshme. E njëjta gjë vlen edhe për të dhënat personale që kanë të bëjnë me dënimet penale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi